



NË SHQIPËRI

Edicioni i 7-të

2-15 dhjetor 2025

Një nismë e



Në bashkëpunim me



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN



Broshurë Informuese

www.weekofintegrity.al

JAVA E INTEGRITETIT NË SHQIPËRI

Java e Integritetit në Shqipëri është një nismë kombëtare ndërgjegjësimi që synon nxitjen e bashkërendimit të përpjekjeve mes aktorëve të ndryshëm për të theksuar rëndësinë e integritetit.

Java e Integritetit synon të promovojë sjelljen etike në të gjithë sektorët, duke përfshirë biznesin, qeverinë, akademinë, OJQ-të dhe shoqërinë në përgjithësi.

Duke inkurajuar pjesëmarrjen nga organizata dhe individë të ndryshëm, ajo nxjerr në pah përgjegjësinë e përbashkët të ruajtjes së integritetit si një vlerë thelbësore në çdo fushë të jetës.

Fushata synon të frymëzojë një kulturë transparence, llogaridhënieje, sjelljeje etike, qeverisje të mirë, dhe çdo përpjekjeje në luftën kundër korrupsionit, duke kontribuar në këtë mënyrë për një shoqëri më etike dhe më të besueshme.



Kur zhvillohet?

Java e Integritetit në Shqipëri zhvillohet çdo vit nga data 1-10 Dhjetor.

Objektivi i Javës së Integritetit nuk kufizohet vetëm në një javë në Dhjetor.

Java e Integritetit është një zotim i ndërmarrë përgjatë gjithë vitit për t'i bashkuar njerëzit rreth parimit të integritetit. Veprimet e përditshme në mënyrë të vazhdueshme luajnë një rol thelbësor që ta bëjnë integritetin një pjesë themelore të mënyrës sesi sillet çdo person, organizatë dhe biznes.

Kush mund të na bashkohet si partner?

Sektori privat dhe ai publik, institucionet arsimore dhe të shoqërisë civile, organizatat rinore, partnerët ndërkombëtarë dhe kushdo që i përkushtohet çështjes së integritetit.

Organizatat që janë partnere të Javës së Integritetit bëhen anëtarë të një rrjeti shumëpalësh.

Partnerët bashkojnë forcat gjatë Javës së Integritetit në Shqipëri duke organizuar aktivitetet e tyre.

Si të bëheni një partner?

Na kontaktoni:

Kontaktoni ekipin e ICC Albania për të diskutuar interesin tuaj dhe aktivitetet e mundshme.

Planifikoni aktivitetet:

Bashkëpunoni me ekipin tonë për të planifikuar aktivitete që përputhen me qëllimet e organizatës suaj dhe temën e integritetit.

Promovoni pjesëmarrjen:

Angazhoni punonjësit dhe rrjetin tuaj për të marrë pjesë dhe mbështetur aktivitetet e Javës së Integritetit në Shqipëri.

Zbatoni dhe ndani përvojat:

Kryeni aktivitetet tuaja të planifikuara dhe ndani përvojat dhe rezultatet tuaja përmes platformës sonë dhe rrjeteve sociale.

Çfarë pritet nga ju si një partner?

Si partner, ju angazhoheni të mbështesni në mënyrë aktive Javën e Integritetit në Shqipëri nëpërmjet:

Lidership Aktiv:

Organizoni një aktivitet tërheqës gjatë Javës së Integritetit (1-10 Dhjetor) që synon rritjen e ndërgjegjësimit.

Komunikimi për Angazhim:

Paraqitni angazhimin tuaj në Javën e Integritetit në Shqipëri duke ndarë përfshirjen tuaj me rrjetin e bashkëpunëtorëve dhe më gjerë.

Pasqyrimi i Logos:

Pasqyroni logon e Javës së Integritetit në mënyrë të dukshme gjatë javës së caktuar, duke simbolizuar qasjen ndaj sjelljes etike të organizatës suaj.

Bashkëpunimi me partnerë të tjerë:

Jini të pranishëm në aktivitetet e Javës së Integritetit, duke përfituar nga mundësia për t'u lidhur me një rrjet ekspertësh me të njëjtin mendim nga fusha të ndryshme duke përfshirë sektorin publik, privat, ligjor, auditim dhe qeverisje.

Bëhuni kreativ dhe ne jemi këtu për t'ju mbështetur kur keni nevojë.

Na kontaktoni

info@weekofintegrity.al

info@icc-albania.org.al



**Privilegj i përdorimit
të logos**



**Angazhim frymëzues
dhe shkëmbim i
praktikave më të
mira**



**Tregoni
angazhimin tuaj**



**Akses ekskluziv
në aktivitete**

Pse të bëhesh partner?

Promovoni një Kulturë Integriteti

Bashkimi si partner për Javën e Integritetit ofron një mundësi unike për të nxjerrë në pah dhe rritur rëndësinë e integritetit brenda organizatës suaj dhe komunitetit më të gjerë.

Forconi Reputacionin e Markës Suaj

Demonstrimi i një përkushtimi ndaj integritetit dhe praktikave etike jo vetëm që përputhet me qëllimet e përgjegjësisë shoqërore të korporatës, por gjithashtu rrit reputacionin e markës suaj.

Angazhoni dhe Frymëzoni Punonjësit

Java e Integritetit ofron një platformë për të angazhuar dhe frymëzuar punonjësit tuaj duke i përfshirë ata në diskutime dhe aktivitete kuptimplota të përqendruara rreth sjelljes etike dhe vendimmarrjes.

Lidhuni me Organizata me të njëjtën Mendësi

Të qenit partner ju lejon që të lidheni me organizata që kanë të njëjtin përkushtim si ju ndaj integritetit. Ky rrjet ofron mundësi të vlefshme për bashkëpunim, shkëmbim njohurish dhe ndërveprim të përbashkët drejt promovimit të standardeve etike në të gjithë industrinë. Angazhimi me kompani të ngjashme përmes aktiviteteve dhe ngjarjeve të përbashkëta rrit ndikimin e Javës së Integritetit dhe nxit krijimin e një komuniteti mbështetës në praktika të mira.

Rrit Besimin e Palëve të Interesuara

Palët e interesuara, duke përfshirë investitorët, klientët dhe punonjësit, kërkojnë siguri se janë të lidhur me një organizatë që vlerëson sjelljen etike. Pjesëmarrja në Javën e Integritetit shënjon përkushtimin tuaj për të ruajtur standarde të larta etike, duke ndërtuar dhe forcuar besimin e palëve të interesuara.

Kontribuoni për një Ndikim më të Gjerë

Përpjekjet tuaja kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe vendosjen e standardeve për sjelljen etike, duke ndikuar kështu në ndryshime pozitive përtej sferës suaj të brendshme.

Aktivitete të Ndryshme që i Përshtaten Organizatës Suaj

Ka mënyra të shumta për të marrë pjesë dhe për të patur një ndikim gjatë Javës së Integritetit. Angazhimi juaj mund të vijë nëpërmjet organizimit të aktiviteteve publike si panele diskutimesh dhe uebinarësh, mbajtjes së sesioneve dhe seminareve të brendshme trajnimi, ose organizimit të fushatave ndërgjegjësuere. Pra, ka opsione të ndryshme që i përshtaten kapacitetit dhe temave të interesit të organizatës suaj. Çdo aktivitet, pavarësisht nga shkalla, kontribuon në qëllimin kryesor të promovimit të integritetit.



**Pasurim
edukativ**




**Vizibiliteti i
markës**



**Rritja e profilin
të organizatës
tuaj**

Cilat mund të jenë disa nga temat?



EDICIONET

Edicioni i Parë

3-11 Shkurt 2020

Ndërtimi i një kulture integriteti: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm

Edicioni i Dytë

1-10 December 2020

Përgjegjësia e qëndrueshme ndaj njerëzve dhe shoqërisë

Edicioni i Tretë

1-10 Dhjetor 2021

Zhvillimi i Qëndrueshëm, Integriteti dhe Lidershipi

Edicioni i Katërt

1-17 Dhjetor 2022

Promovimi i Integritetit: Individit, Organizata dhe më gjerë

Edicioni i Pestë

1-15 Dhjetor 2023

Bashkëpunimi për anëtarësimin në BE: Përforsimi i integritetit nëpërmjet partneriteteve dhe mirëqeverisjes

Edicioni i Gjashtë

1-13 Dhjetor 2024

Nxitja për Integritet: Lundrimi përmes Edukimit, Kërkimit dhe Digjitalizimit

Edicioni i Shtatë

2-15 Dhjetor 2025


Integriteti: Një busull për Demokracinë dhe Konkurrueshmërinë

Ka shumë mënyra se si mund t'i bashkoheni Javës së Integritetit në Shqipëri

Nëse lufta kundër korrupsionit dhe promovimi i integritetit janë të rëndësishme për ju dhe dëshironi të ndihmoni në rritjen e ndërgjegjësisë, nisma Java e Integritetit në Shqipëri ofron një platformë të shkëlqyer për përfshirjen tuaj.



PARTNERËT NDËR VITE të Javës së Integritetit



java e
Integritetit
NË SHQIPËRI

Një nismë e



Në bashkëpunim me



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

www.weekofintegrity.al